

4240
4.23.9.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 721 prot.

Elbasan, më 20.9.2022

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.51 datë 31.05.2022 “Për miratimin e hapjes së rrugës auto në fondin pyjor/kullosor“, si dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese me tuajën nr.4056 prot. datë 14.09.2022, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU



721
08.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt.07.06.2022

Nr. 2723 prot

Nr.51 dt.31.05.2022

“PËR MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS AUTO NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, neni 16 pika 2 dhe neni 22 pika 1, Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive” i ndryshuar, VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, Udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, si dhe bazuar në kontratën e qirasë Nr.526 prot datë 03.02.2020 “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik” të nënshkruar nga z. Idriz Bici me bashkinë Librazhd, pasi dëgjoi relacionin e Drejtorisë së Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit, Keshilli Bashkiak I mbledhur sot me datë 31.05.2022 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për hapjen e rrugës auto për kalimin e mjeteve në vendin e quajtur “Pylli Bicit”, sipas fragment hartes bashkelidhur këtij vendimi.
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit të bashkisë Librazhd.
3. Ky vendim hyjnë në fuqi 10 (dhjetë) dite pas shpalljes.

Sek. i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KËSHILLIT

Shefki Bahiti

